



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI**

Nr. 667/5 Prot.

Tiranë, më 17.09.2018

V E N D I M

Nr. 132, Datë. 17.09 2018

**PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR
NË DREJTORINË E SHËRBIMIT TË TRUPIT DIPLOMATIK, MBI “AUDITIMIN E
PËRPUTHSHMËRISË”.**

Per periudhën nga data 01.01.2017 deri 30.06.2018.

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomatik për periudhën nga data 01.01.2017 deri 30.06.2018, u konstatua se nuk ka devijime materiale apo mospërputhje nga kadri ligjor dhe rregullator në fuqi .Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës,si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “*Mbi auditimit të përputhshmërisë*”, të ushtruar në Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomatik, sipas programit të auditimit nr.667/1 prot, datë 08.06.2018 për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri 30.06.2018.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

A.OPINIONI I AUDITIMIT

Baza për opinionin mbi përputhshmërinë (Ligji për Kontrollin e lartë të Shtetit, standardet INTOSAI si dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, ISSAI 4000 ¹). Nga auditimi i përputhshmërinë, për sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve dhe politikave, mbi të cilat realizohet programi ekonomik (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomantik(DSHTD), konstatohet se pavarësisht vendimmarrjes së Këshillit Drejtues në rishikimin dhe riformatimin e normave të administrimit të brendshëm të shoqërisë, si dhe kufizimit që ju imponon korniza ligjore rregullatore e njësisë të tilla ekonomike, mënyra e menaxhimit është jo në koherencë me tregun konkurrues, dhe e vendos DSHTD në pozita të disfavorshme për maksimizimin e fitimit nga administrimi i aseteve që disponon.

Organet drejtuese nuk kanë shfrytëzuar maksimalisht mundësitë reale që ato kanë , si në burim të ardhurash, asetesh dhe burime njerëzore, për një menaxhim efektiv, eficient dhe me ekonomikitet të pasurisë publike .

Në Opinionin tonë, DSHTD përveç mangësive të identifikuara dhe të trajtuara në Raportin e Auditimit (të cilat nuk janë materiale dhe jo të përhapura), Menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit të brendshëm në DSHTD-^{së} nuk ka funksionuar për shkak të paqartësisë nëse është objekt i zbatimit të ligjit për Menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit brendshëm, për shkak të moszbatimit të tij,evidentohet mungesa e njohurive të plota mbi ligjin dhe për pasojë, drejtuesit nuk e kanë kryer vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në këtë institucion i cili të jetë efektiv për të garantuar përputhshmërinë me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë aktivitetin e institucionit.

Si konkluzion, nga auditimi i përputhshmërisë, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin DSHTD, nuk rezultuan mospërputhje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat nën gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur nuk janë materiale, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të pakualifikuar të përputhshmërisë.¹

B. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi mbi Menaxhimin financiar dhe sistemin e kontrollit të brendshëm në DSHTD-^{së} rezulton se Menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit të brendshëm në DSHTD-^{së} nuk ka gjetur zbatim, për shkak të paqartësisë nëse ky institucion është objekt i zbatimit të ligjit për Menaxhimin financiar dhe sistemin e kontrollit brendshëm(qartësuar me interpretimin nr.11938/1 prot dt.10.07.2018. të Ministrisë së Financave , bazuar në rekomandimin e KLSH-s). Si pasojë e moszbatimit të tij,evidentohet mungesa e njohurive të plota mbi ligjin si nga Drejtuesit dhe punonjësit e DSHTD-^{së} . Organet Drejtuese të institucionit, nuk kanë mundur të bëjnë vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në këtë institucion.

Si pasojë e mos zbatimit të ligjit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe mosnjohjes së tij për vitin 2017- 6 mujour 2018, nuk është hartuar dhe miratuar Deklarata e Misionit të DSHTD-^{së}, dhe nuk ka një Strategji të plotë, e cila të përmbajë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit

¹ **Opinionit i pakualifikuar.** - Jepet në rastet kur në opinionin e audituesit veprimtaria e subjektit përputhet në çdo aspekt material me kriteret e vlerësimit, sa i takon zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë veprimtari.

dhe planet e veprimit, për arritjen e qëllimeve strategjike, me persona konkretë përgjegjës për realizimin e tyre.

Si pasojë e mos zbatimit të ligjit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, nuk janë hartuar gjurmët e auditimit të detajuara për procedurat kryesore, bazuar në gjurmët standarde të emëtuara nga Ministria e Financave. Këto gjurmë të proceseve dhe përgjegjësive, nuk janë identifikuar me emërtimin “Lista e proceseve të punës”, nuk ka miratim dhe arkivim të kësaj gjurme.

Nuk është hartuar regjistri i riskut, dhe adresimi i personave përgjegjës për çdo risk, dhe të përditësohet në vazhdimësi. Nuk janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e Regjistrimit të Risqeve për vitin 2017, monitorimin e kontroleve të risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave, pra nuk është hartuar një regjistër i identifikimit dhe kontrollit të rrisqeve dhe adresimi i personave përgjegjës për çdo risk, i cili duhet të plotësohet, përditësohet në vazhdimësi, si dhe të dërgohet ky regjistër në Ministrinë e Financave, konform përcaktimeve të kreut III “Identifikimi i risqeve” të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Për vitin 2017-2018, nuk është hartuar dhe miratuar Deklarata e Misionit të DSHTD^{-së}, dhe nuk ka një Strategji të plotë, e cila të përmbajë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, për arritjen e qëllimeve strategjike, me persona konkretë përgjegjës për realizimin e tyre.

Nuk janë hartuar gjurmët e auditimit të detajuara për procedurat kryesore, bazuar në gjurmët standarde të emëtuara nga Ministria e Financave. Këto gjurmë të proceseve dhe përgjegjësive, nuk janë identifikuar me emërtimin “Lista e proceseve të punës”, nuk ka miratim dhe arkivim të kësaj gjurme.

Nuk ekziston një protokoll i brendshëm për korespondencat midis strukturave lart-poshtë e paralel, apo raportimet e kryera në nivelin e lartë të strukturave. Mos kryerja e këtyre veprimeve përbëjnë risk në këtë institucion, pasi nuk lihen gjurmë për auditimin e veprimtarisë të nëpunësve të saj.

Në këtë institucion është miratuar Rregullorja e Brendshme, e cila në përgjithësi parashikon raportet punëdhënës-punëmarrës dhe midis vetë punëmarrësve, është hartuar Kodin e Etikës, por ka mangësi në ndarjen e detyrave të punëdhënës-punëmarrës dhe ka raste ku vërehen dublime në përshkrimin e punëve për pozicion. *Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr.50-55 të Raportit të Auditimit.*

Rekomandimi 1.1. Nga struktura drejtuese dhe menaxhuese e këtij institucioni, të merren masa të menjëhershme, për njohjen dhe zbatimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, duke përmirësuar përcaktimin e objektivave strategjikë, rregulloren e brendshme, kodin e etikës, përcaktimin e risqeve të mundshme dhe të gjitha kërkesat e këtij ligji.

Menjherë

2. Gjetje nga auditimi : Nga auditimi mbi zbatimin e kritereve në planifikimin e programit ekonomik, dhe zbatimin e tij, rezultoi se:

- Për hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e programeve ekonomike-financiare institucioni i DSHTD, ka mbetur dhe ruan praktikën tradicionale të hartimit të një programi ekonomik, pa kryer një analizë të thellë të faktorëve me ndikim pozitiv dhe negativ të ambientit në të cilin ky Institucion kryen veprimtarinë. Duke u ekspozuar kështu, në mënyrë të pavetëdijshme ndaj rrisqeve të panevojshme, njëkohësisht, dhe pa rritur fitimin, nëpërmjet një mirëmenaxhimi modern dhe në përputhje me tregun ku operon.

-Programi i zhvillimit duhet të kryhet në analiza dhe vlerësime të hollësishme tekniko-ekonomiko-financiare në mënyrë që treguesit e programit të zhvillimit të jenë real e të besueshëm, duke përdorur analizat SWOT, për të vlerësuar faktorë të cilat përbëjnë ambientin e brendshëm dhe të jashtëm të saj: Fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet ndaj të cilave është e ekspozuar DSHTD.

-Mos kryerja e një analize SWOT nuk i ka mundësuar organeve drejtuese të DSHTD-s përmbledhjen në një kornizë e cila të mundësonte në mënyrë të organizuar analizën e grupeve të faktorëve të sipërpërmendur nga prizmi i një organizate në raport me konkurrentët dhe me segmentin/tet e tregut ose me tregun në përgjithësi. Për më shumë, analiza e faktorëve të sipërpërmendur në mënyrë të qartë në programim mundëson vlerësimin e gjendjes faktike të DSHTD-s për një periudhë vjetore të caktuar, ose 2 vjeçare në një treg të caktuar .

-Gjatë programimit konstatohet copëzim të fondeve për investime dhe mirëmbajtje në objekte të veçanta, si: lyerje e objektit, riparime elektrike, riparime hidraulike, riparime kaldaje etj., për rrjedhojë nuk është arritur efienca dhe efektiviteti i fondeve, pasi çdo vit parashikohen fonde për të njëjtat objekte.

-Parashikimi i investimeve dhe mirëmbajtjeve për çdo vit në objektet e ambasada të RSH-në Athinë, Stokholm, Bruksel dhe Romë pa projekt zbatimi, skica dhe pa shënime teknike për çdo objekt.

-Në hartimin e preventivit paraprak për punime investim- mirëmbajtjes në ambasadat e RSH, nuk janë zbatuar plotësisht kërkesat ligjore ,të parashikuara në manualet teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre, apo klasifikimi dhe struktura e kostos së punimeve të ndërtimit, pasi mungojnë analizat teknike e strukturës së kostos së punimeve të ndërtimit, mangësi kjo e konstatuar vazhdimisht nga auditimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, por e pa korrigjuar plotësisht, edhe pse vërehet një situatë e përmirësuar nga ana e përgatitjes së dosjes dhe dokumentacionit plotësues të investimit. *Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr.6-13 të Raportit të Auditimit.*

Rekomandimi 1.2. Nga struktura drejtuese dhe menaxhuese e këtij institucioni, të punohet për një programim real të shpenzimeve, sipas kërkesave reale të institucionit dhe në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për këtë qëllim, duke eliminuar formalitetin në programimin e këtyre fondeve.

Menjëherë

3.Gjetje nga auditimi : Nga auditimi i veprimeve me bankën dhe arkën konstatohet se mbajtja e llogarive bankare, të rrjedhshme apo depozitë kryhet nëpërmjet 6 bankave të nivelit të dytë, me arsyetimin se klientët me të cilët ka marrëdhënie DSHTD, kanë preferuar bankat e tyre për të vazhduar transaksionet. Kjo praktikë ka shtuar një punë voluminoze dhe të panevojshme që kryhet nga sektori i financës, duke u ekspozuar ndaj riskut të mundshëm, të gabimit njerëzor gjatë rakordimeve apo rritjes së shpenzimeve për komisioneve bankare për transaksione të ndryshme që kryhen nga njëra bankë në tjetrën. Kjo praktike duhej të menaxhohej në favor të DSHTD, duke i kanalizuar veprimet bankare në llogari më të pakta ne numër dhe në ato banka që ofrojnë produkte bankare të favorshme.

-DSHTD nuk rezulton të ketë kryer një studim të tregut bankar për të përzgjedhur bankën më të mirë e cila ofron normën e interesit më të mirë në treg, si dhe bankën që ofron normë interesi konkurruese me bankat e tjera,si klient preferencial të saj, shoqëruar me produkte të larmishme bankare të cilat do të bënin të mundur lehtësimin e veprimtarisë së DSHTD-së.

- DSHTD përgjithësisht për rikonstruksionet e ambasadave jashtë vendit operon me kalimin e shumës së miratuar për investimin, në llogaritë e ambasadave, por u evidentuan raste ku shumat kalojnë në llogaritë personale të personit të cilit i është ngarkuar përgjegjësia e shërbimit që do të kryhet ose në kartën e kreditit të tij, për këto raste në dokumentet e bankës nuk ka bashkëngjitur asnjë ekstrat të veprimeve që ka kryer personi nëpërmjet kartës së kreditit,apo llogarisë së tij, përveç pagesave të kryera në cash ndaj të tretëve për punën e kryer,ose në blerjen e materialeve, në vendin ku kryhet rikonstruksioni.

Pavarësisht vështirësisë së komunikimit me ambasadat, apo dhe komisioneve që ngarkohen nga bankat për transaksionet brenda vendit, DSHTD duhet të gjejë rrugët e duhura që parashikon ligji për kryerjen e këtyre transfertave duke minimizuar riskun e ngjarjeve të paparashikuara , të cilat nuk varen nga individët, dhe minimizimin e përdorimit në cash të çdo veprimi, e cilësojmë

këtë, pasi çdo veprim likuidimi rezulton të jetë kryer në cash në vende evropiane ku tregu bankar dhe transaksionet e një rutine të zakonshme të ditës, përgjithësisht kanalizohen nëpërmjet bankës. *Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr.20-30 të Raportit të Auditimit.*

Rekomandimi 1.3.1 Nga struktura drejtuese dhe menaxhuese e këtij institucioni të kryet një studim i tregut bankar, për të përzgjedhur bankën më të mirë e cila ofron normën e interesit më të mirë në treg, dhe konkurruese me bankat e tjera, duke e trajtuar DSHTD si klient preferencial të saj, shoqëruar me produkte të larmishme bankare të cilat do të bënin të mundur lehtësimin e veprimtarisë së DSHTD-së. Duke qenë se tregu bankar ofron larmishmëri produktesh, DSHTD duhet të negociojnë me bankat të cilat ofrojnë këto shërbime, për komisione sa më të ulta për kryerjen e transaksioneve

Rekomandimi 1.3.2 DSHTD të analizojë dhe gjejë rrugët e duhura që parashikon ligji për kryerjen e transfertave bankare të cilat nevojiten për kryerjen e investimeve jashtë vendit, duke minimizuar riskun e ngjarjeve të paparashikuara, të cilat nuk varen nga individët, dhe minimizimin e përdorimit në cash të çdo veprimi, duke i kanalizuar veprimet nëpërmjet bankës.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi : Nga auditimi i veprimeve me bankën dhe arkën rezultoi se për nevoja të DSHTD përgjatë vitit 2017 janë kryer veprime konvertimi të valutës në lekë ose e kundërta. Transaksionet janë të paraqitura në urdhër xhirimet përkatëse të firmosura nga Drejtori i DSHTD si dhe përgjegjësi i financës, në ekstraktin e bankës pasqyrohej dhe kursi i këmbimit për shumat përkatëse.

Duke qenë se shumat e konvertimit janë në vlerë të konsiderueshme, në total 406,271,691 lekë të konvertuara në monedha të ndryshme ose e kundërta, bashkëngjitur Anex.I “*Konvertimet*”, nuk rezulton në asnjë rast të jetë dokumentuar me një relacion të përgjegjësit të financës mbi arsyet e konvertimit, sasinë e nevojshme për likuiditet, miratuar nga Drejtori i DSHTD, pra nuk ka pasur një programim në fillim të vitit apo dhe muajit për sasisë e likuiditetit që do nevojiten për kryerjen normale të veprimtarisë së DSHTD ,por është kryer konvertim i përqendruar në kohë dhe sasi. Për shkak të menaxhimit që ka preferuar të kryej DSHTD ka humbur shanset për përfitim të ofertave më të mira dhe kurse preferenciale nga bankat. *Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr.20-30 të Raportit të Auditimit.*

Rekomandimi 1.4. Duke qenë se DSHTD ka në administrim të saj sasi të konsiderueshme të vlerave monetare në valutë, (kjo për shkak të të ardhurave të tyre të cilat janë në valutë), duhet të bëjë një studim të hollësishëm të tregut bankar, me qëllim maksimizimin e fitimit dhe humbje sa më të vogla nga këto konvertime. Pra të ketë një programim mbi sasinë që i nevojiten për konvertim , bazuar në nevojat për likuiditet për pagesat vjetore dhe mujore, kjo do të ulte riskun e humbjes nga kursi i këmbimit, por ndërkohë programimi do jepte shanset për oferta më të mira për kurse preferenciale, mundësi që DSHTD e ka humbur, për shkak të menaxhimit që ka preferuar të kryej.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, i procesit të inventarizimit në këtë institucion dhe dokumentimit të tij, rezultoi se në përfundim të inventarizimit, janë përgatitur listat për çdo llogari dhe për çdo nëpunës që ka në ngarkim mjetet dhe objektet inventariale, si dhe përmbledhësja e të gjitha kartelave të inventarit, të firmosura nga personat përgjegjës dhe anëtarët e komisionit të inventarizimit, por nuk rezulton të jetë hartuar një raport i detajuar nga komisioni i inventarizimit, për titullarin e institucionit, lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësim paraprak të cilësisë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike, si dhe materialet që janë për të dalë jashtë përdorimit. *Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr.20-30. të Raportit të Auditimit.*

Rekomandimi 1.5. Nga strukturat drejtuese si dhe sektori i financës të merren masat që nga ana e komisioneve që ngrihen për kryerjen e procesit të inventarizimit të hartohet një raport i detajuar nga komisioni i inventarizimit, për titullarin e institucionit, lidhur me inventarizimin e gjithë aseteve të qëndrueshme dhe qarkulluese, të këtij institucioni, si për gjendjen fizike të aktiveve, vlerësim paraprak të cilësisë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, si dhe materialet që janë për të dalë jashtë përdorimit dhe asgjësimin e tyre, sipas legjislacionit në fuqi.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procedurat e prokurimit publik, rezultoi se, për vitet objekt auditimi 2017 dhe 2018, për mallra apo grup mallrash me funksion të njëjtë autoriteti kontraktor në disa raste ka bërë copëzim fondi të pa arsyetuar dhe të paargumentuar. Për mallrat të ndryshëm si vegla pune, pajisje kaldajash, pajisje hidrosanitare, mirëmbajtje e ndarë nga prokurimi i mallit rezultoi se janë shmangur procedurat e prokurimit publik. Ky veprim ka shmangur konkurrencën dhe përdorimin e fondeve me efektivitet, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, I ndryshuar, neni 40, pika 1 “Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup – mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure” dhe pika 8 “Në asnjë rast, procedura e prokurimit me vlerë të vogël nuk duhet të përdoret si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës për shmangien nga procedurat konkurruese të prokurimit”. *Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr.30-40 të Raportit të Auditimit.*

Rekomandimi 1.6. Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik të marrë masa të menjëhershme në hartimin e regjistrimit të parashikimeve të mos bëhet copëzim fondi. Mallrat apo grup mallrat duhet të grupohen sipas funksionit me qëllim mos shmangien e procedurave të prokurimit dhe përdorimin e fondeve me efektivitet në përputhje me VKM nr.914 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40, pika 1 dhe 8.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se gjatë vitit 2017 nga DSHTD janë dhënë me qira 85 objekte dhe janë përfutur prej tyre, të ardhura nga qiraja në vlerën total 161,099,709 lekë, ndërsa për periudhën deri më 30.06.2018 janë dhënë me qira 43 objekte dhe janë përfutur prej tyre të ardhura në vlerën total 88,553,522 lekë. Nga grupi i punës për vendosjen e tarifave të dhënies me qira të pasurisë, ndërtesa, truall i lirë, truall i lirë funksional, në administrim të DSHTD-së, vënë në dispozicion për subjektet vendase dhe të huaj, nuk rezultoi të jetë kryer një studim i plotë bazuar në testimin e tregut dhe çmimet zyrtare të referencës së përcaktuar në VKM përkatëse me qëllim përmirësimin e të ardhurave të shoqërisë. *Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr.13-20 të Raportit të Auditimit.*

Rekomandimi 1.7. DSHTD pavarësisht, vështirësisë që u jep statusi specifik këtyre pasurive duhet të marrë masa të menjëhershme për zbatimin me korrektësi të procedurave të miratuara për vendosjen e çmimeve të qerave, me qëllim maksimizimin e të ardhurat që përfitohen prej tyre.

-KD të rishikojë çmimet e qerasë të propozuara nga grupi i punës për studimin e tarifave të dhënies me qira të pasurisë ndërtesa, truall i lirë, truall i lirë funksional, në administrim të DSHTD-së, vënë në dispozicion për subjektet vendase dhe të huaj të cilat janë më të ulta se çmimi i tregut dhe çmimet zyrtare të referencës së përcaktuar VKM përkatëse në kohën e lidhjes së kontratës me qëllim përmirësimin e të ardhurave të shoqërisë.

-DSHTD në të ardhmen të kërkojë grupit të punës për studimin e tarifave të dhënies me qira të pasurisë ndërtesa, truall i lirë, truall i lirë funksional, në administrim të DSHTD-së, vënë në dispozicion për subjektet vendase dhe të huaj të testojë tregun në përputhje me çmimin e tregut dhe çmimet zyrtare të referencës së përcaktuar në VKM përkatëse.

Menjëherë

C. GJETJE ME EFEKTE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN, MENAXHIMIN PA EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

Gjetje për fonde të trajtuara pa efektivitet dhe ekonomikitet .

1. Gjetje nga auditimi: Me urdhrin e titullarit nr. 49 datë 24.01.2017, është ngritur grupi i punës, për dërgim me shërbim në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në **Stokholm**, me qëllim përcaktimin e nevojave për kryerjen e riparimeve në godinën e Ambasadës së RSH-së në Stokholm, kryerjen e matjeve faktike dhe testimin të tregut për hartimin e preventivave të punimeve për investimet që do të kryhen.

- Me procesverbalin e grupit të punës të mbajtur më 15.03.2017, kanë marrë të dhëna për studimin e tregut për çmimet në magazina, dyqane si dhe oferta për disa punime shërbimi. Në procesverbal paraqiten çmime për materiale ndërtimit si rërë, çimento, bojë plastike, stuko, pllaka, dyer etj. Gjithashtu ka marrë oferta nga palë të treta për punimet si më poshtë:

1. Rikonstruksionit të tualetit të vogël, me ofertë "*komplet*" 4,400 euro.
2. Zmontim-Montim dritare termike dopio xham "*komplet*" 8,000 euro.
3. Dizinfektim i katit përdhe brenda dhe jashtë "*komplet*" 1,600 euro.
4. F.V skela montimi 15 ditë 160 m2, me çmim 20 euro, me vlerë 3,200 euro.

Në total tarifa për palët e treta rezulton në vlerë **17,200 euro**.

Gjithashtu në preventivin e punimeve për godinën në Stokholm, përcaktohet edhe nevoja e punime që do të kryhen nga punëtorët e DSHTD-së, të nxjerra me çmimet e VKM nr. 629, datë 15.07.2015 "*Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*". Nevoja për punëtorinë e përcaktuar nga Ing. E.Th., përcakton specialistët që nevojiten (*punëtor, murator, marangoz, dural, hidraulik, bojaxhi dhe elektrikist*), duke përcaktuar edhe orët e punës që duhen për secilin specialist.

Në preventivin e punimeve të cilat do të kryhen nga punëtorët e DSHTD-së, përcaktohen punimet si më poshtë:

-Rrashnim llakim parketi, ndërtim muri gipsi, veshje me letër muri, lyerje me bojë, F.V parket, F.V dere e brendshme, patinime, F.V kuti+suporte, celsa, O.P për punime elektrike, F.V ëc+kasete, F.V lavamane, F.V grupe dushi etj, riparime pllakash, pastrime, transporte materiale dhe mbeturina etj. Gjithashtu, në preventivin për 8 specialistët dhe përgjegjësin e grupit, janë likuiduar të gjitha shpenzimet për transportin, akomodimin dhe dietat.

- Me aktin e rakordimit nr. 151/3 prot. datë 21.03.2017, grupi i vlerësimit së bashku me Ambasadën e Stokholmi, kanë realizuar inspektimin dhe është arritur në konkluzion se duhet të ndërhyhet në ambiente të brendshme të godinës dhe në ambientet e jashtme.

- Me urdhrin e titullarit të DSHTD-së nr. 176, datë 12.05.2017, urdhërohet grupi i punës për ndjekjen e kryerjes së punimeve në godinën e ambasadës së R.SH-së në **Stokholm**, sipas preventivit për investimeve të vitit 2017 me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 09 datë 09.05.2017. Me relacionin e grupit të punës nr. 543/16 prot. datë 12.11.2017, citohet se punimet e planifikuara përfshijnë ndërhyrje për rikonstruksion të pjesshme si në godinën e ambasadës dhe në apartamentet e diplomatëve. Punimet e rikonstruksionit përfshijnë rehabilitim i tualetit të ambasadës në katin e parë, rikonstruksion të dritareve,sallave, mure, riparime të ndryshme dhe lyerje. Në përfundim nga Ing. E.Th si përgjegjës i grupit të punës, kërkohet të miratohet investimi i kryer në vlerën e përgjithshme të situacionit përfundimtar prej 41,827 Euro.

- Me urdhrin nr. 188 datë 25.05.2017, ngrihet komisioni i prokurimit me vlera të vogla i përbërë nga E. Th, A. B dhe O. B, të cilët kanë realizuar blerjet e mallrave dhe pagesat me palët e treta.

Sa më sipër, mbi përcaktimet e punimeve me punëtorët e DSHTD-së, nuk janë bashkëlidhur analizat e çmimeve, por janë vendosur vetëm numrat e analizave të punimeve, duke mos saktësuar çmimet sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015, për shpenzimet plotësuese 8%, fitimin 10 % dhe punëtorinë apo sigurimet shoqërore të punëtorisë prej 16.7%, të cilat nuk janë argumentuar pasi specialistët janë punëtorë të DSHTD-së.

- Në preventivin e hartuar për rikonstruksionin e godinës së ambasadës në Stokholm, mbi punimet e të tretëve, ka disa punime të mbivendosura të cilat mund të realizoheshin lehtësisht

nga specialistët e DSHTD-së, si në rikonstruksionin e tualeteve, si në punimet e dyerve, si në skelat metalike apo edhe të dizifektimit të ambineteve, duke përdorur fondet publike pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficensë.

- Në preventivin e ofertave me palët e treta, ku me njësinë "Komplet", nuk është përcaktuar specifikisht puna që do kryer dhe nëse materialet ndërtimore do të blihen nga palët e treta apo nga DSHTD-ja, pasi shumë materiale blihen nga DSHTD-ja, me procedurë blerje e vogël.

- Nga punimet me palët e treta, nuk ekziston asnjë kontratë apo marrëveshje, midis operatorëve ekonomik dhe DSHTD, ku të përcaktohen afate, specifikime, sanksione për defekte etj, por vetëm fatura likuidimi të punimeve.

2. Gjetje nga auditimi: - Me urdhrin e titullarit nr. 51 datë 24.01.2017, ngrihet grupi i punës, për dërgim me shërbim në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Athinë, Qëllimi i shërbimit është kontrolli i nevojave për kryerjen e riparimeve në godinën e Ambasadës së RSH-së në Athinë, kryerjen e matjeve faktike dhe testimit të tregut për hartimin e preventivave të punimeve për investimet që do të kryhen.

- Me procesverbalin e grupit të punës dhe Ambasadores së RSH-së Athinë, të mbajtur më 12.07.2017, kanë lindur nevoja për ndryshime dhe shtesa të planit të punimeve të DSHTD-së, duke përdorur burimet financiare të planifikuara për vitin 2017, pa realizuar shtesa. Punimet që janë të nevojshme të shtohen përfshijnë :

1. Lyerje komplet të zyrës së Ambasadores
2. Pastrim total higjenik i ambienteve të Ambasadës
3. Lyerje e ashensorit jashtë dhe brenda
4. Lyerje me llak e tullave dekorative në hyrje të Ambasadës
4. Lyerje me bojë dalluese të verdhë e parkimit.

Për riparimet në Ambasadën e RSH-së Athinë, është hartuar preventivi i punimeve, i ndarë në dy pjesë me ofertat e marra nga palat e treta dhe me specialistët e DSHTD-së. Punimet të cilat do të realizoheshin nga palët e treta përfshijnë:

1. Lucidim mermeri (zyrë ambasadori+veranda), me ofertë 3,600 euro.
2. F.V Sistem i plotë vëzhgimi me kamera infra red "komplet" 4,500 euro.
3. Punime dezifektimi garazhdit, magazinës dhe zyrave "komplet" 1,100 euro.

Në total tarifa për palët e treta rezulton në vlerë 9,200 euro.

Gjithashtu në preventivin e punimeve për godinën në Athinë, përcaktohet edhe nevoja e punime që do të kryhen nga punëtorët e DSHTD-së, të nxjerra me çmimet e VKM nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre". Nevoja për specialistë (dural, murator, bojaxhi, elektrik, hidraulik dhe lulishtar), janë përcaktuar nga Ing. E. Th, ku nuk janë përcaktuar orët e punës që duhen për secilin specialist, në përputhje me volumin e punimeve.

Në preventivin e punimeve të cilat do të kryhen nga punëtorët e DSHTD-së, përcaktohen punimet si më poshtë:

-F.V kasete tualeti, riparime parketi, F.V brava, riparime qepeni, riparime ndryshme elektrike, lyerje, sistemim lulishteje, riparim sistemi hidraulik, pastrime, transporte etj. Gjithashtu, në preventivin për 8 specialistët dhe përgjegjësin e grupit, janë likuiduar të gjitha shpenzimet për transportin, akomodimin dhe dietat.

- Me urdhrin e titullarit të DSHTD-së nr. 215, datë 26.06.2017, urdhërohet grupi i punës për ndjekjen e kryerjes së punimeve në godinën e ambasadës së R.SH-së në Athinë, sipas preventivit për investimeve të vitit 2017 me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 12 datë 23.06.2017.

- Me urdhrin nr. 228 datë 03.07.2017, ngrihet komisioni i prokurimit me vlera të vogla, të cilët kanë realizuar blerjet e mallrave dhe pagesat me palët e treta.

- Me relacionin e grupit të punës nr. 688/13 prot. datë 30.08.2017, citohet se punimet e planifikuara në godinën e ambasadës, ku në bazë të faturave të blerjeve të materialeve u hartua situacioni përfundimtar në vlerën e përgjithshme prej 32,055 Euro.

Sa më sipër, mbi përcaktimet e punimeve me punëtorët e DSHTD-së, nuk janë bashkëlidhur analizat e çmimeve, por janë vendosur vetëm numrat e analizave të punimeve, duke mos

saktësuar çmimet sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015, për shpenzimet plotësuese 8%, fitimin 10 % dhe punëtorinë apo sigurimet shoqërore të punëtorisë prej 16.7%, të cilat nuk janë argumentuar pasi specialistët janë punëtorë të DSHTD-së.

- Në preventivin e hartuar për rikonstruksionin e godinës së ambasadës në Athinë, mbi punimet e të tretëve, ka disa punime të cilat mund të realizoheshin lehtësisht nga specialistët e DSHTD-së, si në lucidimet e mermerit apo edhe të dizifektimit të ambienteve.

- Nga punimet me palët e treta, nuk ekziston asnjë kontratë apo marrëveshje, midis operatorëve ekonomik dhe DSHTD, ku të përcaktohen afate, specifikime, sanksione për defekte etj, por vetëm fatura likuidimi të punimeve.

3.Gjetje nga auditimi: - Me relacionin nr. 44 datë 10.01.2017, në godinën e ambasadës së RSh-së në Romë, bazuar urdhrin nr. 360 datë 31.10.2016 të titullarit të DSHTD-së, grupi i punës ka inspektuar godinën dhe apartamentet e diplomatëve, ku testoi tregun për materialet ndërtimore dhe ka hartuar Akt-rakordimin e përbashkët me ambasadën. Si përfundim nga grupi i punës kërkohet miratimi i vlerës së plotë të objektin në vlerën 50,338 euro.

Me anë të testimit të tregut, grupi i punës ka marrë oferta si më poshtë:

1. Zëvendësim i mbulesës së Kaldajës "komplet" 2,881 euro.
2. Ndërtim shkallësh për tarracën dhe ashensorin "komplet" 5,124 euro.
3. Sistemim i aspirimit të konsullatës "komplet" 6,563 euro.
4. Lucidim i mermerit, me çmim 25 euro, me vlerë 2,250 euro.
5. F.V depozitë uji + elktropompë në tarracë "komplet" 5,685 euro.
6. Punime kondicionimi "komplet" 5,180 euro.

Në total tarifa për palët e treta rezulton në vlerë 27,683 euro.

Gjithashtu në preventivin e punimeve për godinën në Romë, përcaktohet edhe nevoja e punime që do të kryhen nga punëtorët e DSHTD-së, të nxjerra me çmimet e VKM nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre". Nevoja për punëtorinë e përcaktuar nga Ing. Edmond Theodori, përcakton specialistët që nevojiten (punëtor, murator, marangoz, dural, hidraulik, bojaxhi dhe elektrikist/mekanik), duke përcaktuar edhe orët e punës që duhen për secilin specialist.

Në preventivin e punimeve të cilat do të kryhen nga punëtorët e DSHTD-së, përcaktohen punimet si më poshtë:

-Punime në godinën e ambasadës dhe apartamentet e diplomatëve. Gjithashtu, në preventivin për 8 specialistët dhe përgjegjësin e grupit, janë likuiduar të gjitha shpenzimet për transportin, akomodimin dhe dietat.

-Me urdhrin e titullarit nr. 281 datë 01.03.2017, ngrihet grupi i punës, për dërgim me shërbim në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Romë, i përbërë nga z. E. Th. dhe specialistët e ndërtimit. Qëllimi i shërbimit është për kryerjen e riparimeve në godinën e Ambasadës së RSH-së në Romë, referuar sektorit të planifikimit nr. 44 datë 10.01.2017, miratuar me Vendim nr. 02 datë 13.01.2017 të Këshillit Drejtues.

- Me urdhrin nr. 130 datë 20.03.2017, ngrihet komisioni i prokurimit me vlera të vogla, të cilët kanë realizuar blerjet e mallrave dhe pagesat me palët e treta.

Sa më sipër, mbi përcaktimet e punimeve me punëtorët e DSHTD-së, nuk janë bashkëlidhur analizat e çmimeve, por janë vendosur vetëm numrat e analizave të punimeve, duke mos saktësuar çmimet sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015, për shpenzimet plotësuese 8%, fitimin 10 % dhe punëtorinë apo sigurimet shoqërore të punëtorisë prej 16.7%, të cilat nuk janë argumentuar pasi specialistët janë punëtorë të DSHTD-së.

- Në preventivin e hartuar për rikonstruksionin e godinës së ambasadës në Romë, mbi punimet e të tretëve, ka disa punime të cilat mund të realizoheshin lehtësisht nga specialistët e DSHTD-së, duke përdorur fondet publike pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficensë.

- Në preventivin e ofertave me palët e treta, ku me njësinë "Komplet", nuk është përcaktuar specifikisht puna që do kryer dhe nëse materialet ndërtimore do të blihen nga palët e treta apo nga DSHTD-ja, pasi shumë materiale blihen nga DSHTD-ja, me procedurë blerje e vogël.

- Nga punimet me palët e treta, nuk ekziston asnjë kontratë apo marrëveshje, midis operatorëve ekonomik dhe DSHTD, ku të përcaktohen afate, specifikime, sanksione për defektesh etj, por vetëm fatura likuidimi të punimeve.

4. Gjetje nga auditimi: - Me urdhrin nr. 50 datë 24.01.2017 të titullarit të DSHTD-së, grupi i punës ka inspektuar godinën dhe apartamentet e diplomatëve, ku testoi tregun për materialet ndërtimorë dhe ka hartuar Akt-rakordimit e përbashkët me ambasadën së RSh-së në **Bruksel**, bazuar në Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 9 datë 09.05.2017, ku miratohet vlerës së plotë të objektin në vlerën 35,771 euro.

-Me urdhrin e titullarit nr. 177 datë 12.05.2017, ngrihet grupi i punës, për dërgim me shërbim në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në **Bruksel**, i përbërë nga z. Roland Fortuzi dhe specialistët e ndërtimit. Qëllimi i shërbimit është për kryerjen e riparimeve në godinën e Ambasadës së RSH-së në Bruksel.

- Me urdhrin nr. 189 datë 25.05.2017, ngrihet komisioni i prokurimit me vlera të vogla, të cilët kanë realizuar blerjet e mallrave dhe pagesat me palët e treta.

- Me aktin e rakordimit nr. 544/13 datë 20.06.2017, mbi punimet e kryera në godinën e RSH-së Bruksel, deklarohen se janë kryer punime në katin e parë, dytë, tretë, katërt, pestë, në bodrum dhe të ndryshme. Në situacionin e punimeve deklarohen shpenzimet për materiale në shumën 20,387 euro dhe në total shpenzimet me dieta, hotel rezulton në vlerën 34,043 euro. Në dosjen e shpenzimeve gjendet ditari i punimeve, librezat e masave dhe formularët e blerjeve të mallrave.

Sa më sipër, mbi përcaktimet e punimeve me punëtorët e DSHTD-së, nuk janë bashkëlidhur analizat e çmimeve, por janë vendosur vetëm numrat e analizave të punimeve, duke mos saktësuar çmimet sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015, për shpenzimet plotësuese 8%, fitimin 10 % dhe punëtorinë apo sigurimet shoqërore të punëtorisë prej 16.7%, të cilat nuk janë argumentuar pasi specialistët janë punëtorë të DSHTD-së.

5. Gjetje nga auditimi: - nga kryerja e punimeve në ambasadën së RSh-së në **Washington DC**. Për godinën e Misionit të Përhershëm të RSH pranë OKB-së në New York, drejtuar Këshillit Drejtues, është llogaritur se shpenzimet me të tretë dhe shpenzimet e akomodimit, punimet sipas preventivit rezultojnë në 99,160 dollarë amerikan.

Punimet me palët e treta rezultojnë në vlerën 69,616 dollarë.

Punimet me punëtorët e DSHTD-së rezultojnë në vlerën 11,353 dollarë

Shpenzimet e punëtorisë rezultojnë në vlerën 18,190 dollarë.

- Me urdhrin nr. 72 datë 01.02.2017, urdhërohet ngritja e grupit të punës për kryerjen e punimeve në ambasadën së RSh-së në **Washington DC**, i përbërë nga 5 vetë.

- Me urdhrin nr. 122 datë 13.03.2017, ngrihet komisioni i prokurimit me vlera të vogla, të cilët kanë realizuar blerjet e mallrave dhe pagesat me palët e treta.

-Nga specialistët e DSHTD-së, janë llogaritur specialist si murator, punëtor dhe bojaxhi të cilët do tërealizojnë punime suvatimi në fasadë, lyerje e brendshme dhe jashtme, hidroizolim muresh, F.V pllaka gres dhe transporte materialesh.

Situacioni përfundimtar i punimeve në godinën e Misionit të përhershëm të RSH-së pranë OKB-së ne New York rezultoi në vlerën 97,674 dollarë, ku me shkresë nr. 836 prot. datë 20.07.2017, drejtuar Këshillit Drejtues kërkohet miratimi i investimit.

Sa më sipër, mbi përcaktimet e punimeve me punëtorët e DSHTD-së, nuk janë bashkëlidhur analizat e çmimeve, por janë vendosur vetëm numrat e analizave të punimeve, duke mos saktësuar çmimet sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015, për shpenzimet plotësuese 8%, fitimin 10 % dhe punëtorinë apo sigurimet shoqërore të punëtorisë prej 16.7%, të cilat nuk janë argumentuar pasi specialistët janë punëtorë të DSHTD-së.

- Në preventivin e hartuar për rikonstruksionin e godinës së ambasadës në Washington, mbi punimet e të tretëve, ka disa punime të mbivendosura të cilat mund të realizoheshin lehtësisht nga specialistët e DSHTD-së.

- Në preventivin e ofertave me palët e treta, ku me njësinë "*Komplet*", nuk është përcaktuar specifikisht puna që do kryer dhe nëse materialet ndërtimore do të blihen nga palët e treta apo nga DSHTD-ja, pasi shumë materiale blihen nga DSHTD-ja, me procedurë blerje e vogël.

- Nga punimet me palët e treta, nuk ekziston asnjë kontratë apo marrëveshje, midis operatorëve ekonomik dhe DSHTD, ku të përcaktohen afate, specifikime, sanksione për defektesh etj, por vetëm fatura likuidimi të punimeve.

6. Gjetje nga auditimi: Në zbatim të pikës nr. 5 të programit të auditimit mbi "Prokurimet e fondeve publike për periudhën 2015-2017", u shqyrtua dokumentacioni si i kontratave të punëve, mallrave dhe shërbimeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të likuidimit nëpërmjet bankës për objektin "**Rikonstrukcion i plotë i vilës nr. 88**", konstatohet:

6.1. Në zërin e ri "**Sistemi Kapot**" të paparashikuar në preventivin fillestar, të propozuar nga sipërmarrësi është paraqitur analiza e çmimit e cila është bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 629, datë 15.07.2015 "*Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*", i cili e paraqet zërin e "Veshje fasade me polisterol jeshil $t=5\text{cm} + \text{rrjete} + \text{suva}$ ", me çmimin 2,869 lekë/m², ku përfshihet edhe skela brenda çmimit, në të cilën sipërmarrësi e ka zbritur në kostot e tij, pasi është zë më vehte.

Në analizën e paraqitur nga kontraktori, në "*sistemin kapot*" përfshihet edhe Grafiato për suva. **Ndërkohë**, në po në të njëjtin kapitull të punimeve të suvatimit dhe veshjes, zëri 9, nr. anal. 2.308/a, është zëri "Suvatim me grafiato $h>4\text{m}$ ", me çmimin e ofertuar 1,030 lekë/m², është likuiduar në situacionin përfundimtar në sasinë prej 740 m², i cili është i mbivendosur në mënyrë të paarsyeshme, pasi vetë "*Suvatimi grafiato*" përfshihet në zërin e "*Sistemit kapot*".

Gjithashtu, bazuar në llogaritjet e librezave të masave, për sistemin e termoizolimit të fasadës në sistemin kapot, është llogaritur e gjithë fasada në të gjitha anët (Veri, Lindje, Perëndim, Jug), në sasinë prej 1,150 m² dhe mungojnë llogaritjet për zërin e "Suvatim me grafiato $h>4\text{m}$ ", të likuiduara në situacionin përfundimtar, në sasinë 740 m², si edhe disa zëra të tjerë punimesh.

Sa më sipër, mbështetur në analizën e çmimit të dhënë nga vetë sipërmarrësi për "sistemin kapot", ku përfshin edhe suvatimin me grafiato, rrjedhimisht, zëri i "Suvatimit me grafiato $h>4\text{m}$ ", është zë pune i mbivendosur në vlerën 762,200 lekë pa TVSH ose 914,640 lekë me TVSH.

6.2 Në Punimet e Instalimeve Elektrike, kapitulli i kuadrove elektrike kryesor.

Në situacionin përfundimtar të punimeve në kapitullin e mësipërm, të gjitha zërat e punimeve të kabinetit, pllakave, paneleve, zbarave, dyerve, suporteve, shinave, automateve, transformatorëve, morseterive etj, janë llogaritur për "**Furnizim dhe Vendosje**". Nga projektuesi "D." sh.p.k, ku projekt-preventivi Elektrik, është hartuar nga Ing. D. M., ka kryer analizat e çmimeve për të gjitha punimet elektrike. Në kapitulli i kuadrove elektrike kryesor, projektuesi ka vendosur zërin nr. 29 me nr. analize E-2.29 "F.V Montim kuadri, morseteri, zbara, kabllime, kanalina, aksesore etj", me analizën e çmimit.

Për sa më sipër, në hartimin e preventivit elektrik konstatohen zëra pune të mbivendosura zërave të punimeve, duke rritur fondin limit të preventivit, në kundërshtim me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 "*Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*", ç'ka ngarkon me përgjegjësi projektuesin e objektit.

Ndërkohë, në situacionin përfundimtar të sipërmarrësit të zbatimit të punimeve është likuiduar zëri nr. 29 "F.V Montim kuadri, morseteri, zbara, kabllime, kanalina, aksesore etj", në vlerën 21,250 lekë pa TVSH ose 25,500 lekë me TVSH, të përfituara padrejtësisht, pasi është zë pune i mbivendosur në instalimet elektrike të cilat janë të gjitha "**Furnizim Vendosje**". Mbështetur në llojin e kontratës "Me matje", ku kontraktori paguhet për sasinë e realizuar, nga mbikëqyrësi i punimeve, duhej zbritur vlera e zërit të "F.V Montim kuadri, morseteri, zbara, kabllime, kanalina, aksesore etj".

6.3 Në Punimet e Instalimeve Elektrike, kapitulli i kuadrit elektrike kati përdhe.

Për punimet elektrike në katin përdhe, është e njëjta mospërputhje si më sipër, ku të gjitha zërat pllakë, kuadër, suport+shina, zbara, automate, morseterira etj, janë të gjitha "**Furnizim + Vendosje**". Përsëri në zërin nr. 20, me nr. analize E-3.14, është vendosur zëri "F.V Montim kuadri, morseteri, zbara, kabllime, kanalina, aksesore etj", i cili është i mbivendosur. për vlerën prej 12,750 lekë pa TVSH ose 15,300 lekë me TVSH.

6.4 Në Punimet e Instalimeve Elektrike, kapitulli i kuadrit elektrikë kati parë.

Për punimet elektrike në katin parë, është e njëjta mospërputhje ku të gjitha zërat pllakë, kuadër, suporte+shina, zbara, automate, morseterira etj, janë të gjitha "**Furnizim + Vendosje**". Përsëri në zërin nr. 21, me nr. analize E-3.14, është vendosur zëri "*F.V Montim kuadri, morseteri, zbara, kabllime, kanalina, aksesore etj*", i cili është i mbivendosur, për vlerë prej 12,750 lekë pa TVSH ose 15,300 lekë me TVSH.

6.5 Në Punimet e Instalimeve Elektrike, kapitulli i kuadrit elektrikë kati dytë.

Për punimet elektrike në katin dytë, është e njëjta mospërputhje ku të gjitha zërat pllakë, kuadër, suporte+shina, zbara, automate, morseterira etj, janë të gjitha "**Furnizim + Vendosje**". Përsëri në zërin nr. 28, me nr. analize E-2.29, është vendosur zëri "*F.V Montim kuadri, morseteri, zbara, kabllime, kanalina, aksesore etj*", i cili është i mbivendosur, për vlerën prej 21,250 lekë pa TVSH ose 25,500 lekë me TVSH.

6.6 Në Punimet e Instalimeve Elektrike, kapitulli i kuadrit elektrikë i apartamentit.

Për punimet elektrike i apartamentit, është e njëjta mospërputhje ku të gjitha zërat pllakë, kuadër, suporte+shina, zbara, automate, morseterira etj, janë të gjitha "**Furnizim + Vendosje**". Përsëri në zërin nr. 14, me nr. analize E-6.4, është vendosur zëri "*F.V Montim kuadri, morseteri, zbara, kabllime, kanalina, aksesore etj*", i cili është i mbivendosur, për vlerën prej 4,250 lekë pa TVSH ose 5,100 lekë me TVSH.

6.7 Në Punimet e Instalimeve Elektrike, kapitulli i kuadrit elektrikë i podrumit.

Për punimet elektrike i podrumit, është e njëjta mospërputhje ku të gjitha zërat pllakë, kuadër, suporte+shina, zbara, automate, morseterira etj, janë të gjitha "**Furnizim + Vendosje**". Përsëri në zërin nr. 13, me nr. analize E-6.4, është vendosur zëri "*F.V Montim kuadri, morseteri, zbara, kabllime, kanalina, aksesore etj*", i cili është i mbivendosur, për vlerën prej 4,250 lekë pa TVSH ose 5,100 lekë me TVSH.

6.8 Në Punimet e Instalimeve Elektrike, kapitulli i kuadrit elektrikë UPS.

Për punimet elektrike i UPS, është e njëjta mospërputhje ku të gjitha zërat pllakë, kuadër, suporte+shina, zbara, automate, morseterira etj, janë të gjitha "**Furnizim + Vendosje**". Përsëri në zërin nr. 12, me nr. analize E-6.4, është vendosur zëri "*F.V Montim kuadri, morseteri, zbara, kabllime, kanalina, aksesore etj*", i cili është i mbivendosur, për vlerën prej 4,250 lekë pa TVSH ose 5,100 lekë me TVSH.

Në total për punimet elektrike, janë mbivendosur zëra punime, në vlerën 96,900 lekë me TVSH.

Rekomandimi : Nga Strukturat Drejtuese të DSHTD-së, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, brenda kuadrit rregullator të veprimtarisë së tyre, të mari masa të menjëhershme për analizimin e shkaqeve, arsyet dhe përgjegjësitë, për mos përdorimin me efektivitet dhe ekonomikitet të fondet buxhetore në vlerat e mësipërme, për investimet e kryera.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenin 37 "*Masat disiplinore*", të Kodit të Punës , si dhe Kontratës dhe Individuale të Punës lidhur midis punonjësve dhe Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik i rekomandojmë Drejtorit të DSHTD-s: Të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësive, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, dhe të kërkojë fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R